

## Kërkesë për shpalljen e njoftimit publik

Bazuar në urdhërin me nr 104., datë 06.03.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për përzgjedhjen e ambientit privat që do të merret me qera nga ana e Bashkisë Durrës që do të shërbejë për ngritjen e qendrës së”PERMIRESIMIT TE REZILENCES SE KOMUNITETEVE”, në mbështetje të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligji nr. 8561, datë 22.11.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar, Memorandumit të Mirëkuptimit midis Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe Bashkisë Durrës nr.2327 prot., datë 01.03.2023 si dhe shkresës të Drejtorisë së Shërbimit Social nr.2407 prot., datë 02.03.2023.

Për sa më lart grupi i punës, duke marrë parasyshë numrin e punonjësve dhe detyrat funksionale që do të kryhen në këto ambiente, vlerësoi që pasuria që kërkohet të merret me qira të përmbush këto kritere:

- Të jetë e përshtatshme dhe të përmbajë sipërfaqen e nevojshme për 4 ambiente të cilat do të përdoren për; shërbime psikologjike, shërbime fizioterapike, klasa për fëmijë.
- Të ketë një ambient për magazinim të bazës materiale si dhe 2 tualet për femra dhe meshkuj dhetalet të përshtatur për persona me aftësi të kufizuar.
- Të ketë jashtë godinës një ambient për të zhvilluar aktivitete të ndryshme dhe akses në godinë përpersonat me aftësi të kufizuar.
- Ambienti që do të merret me qira të jetë brenda territorit të Njësisë Administrative Nr.1, në të cilën mungojnë shërbimet me bazë komunitare.
- Të ketë një sipërfaqe duke filluar nga 300 m<sup>2</sup>.
- Afati i dorzimit të ofertave është 15 ditë mbas publikimit në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës.

Dokumentacioni që do të paraqesin konkurentët janë:

- Kërkesa për dhënin me qira ku do të deklarohet **oferta për vlerën e detyrimit mujor të qirasë.**
- Kartën e identitetit.
- Dokumentin e pronësisë të njehsuar me origjinalin.
- Deklaratë nëse është në ndjekje penale, si dhe nëse ka proces gjyqësor në lidhje me ambientin.
- Deklaratë se mban përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e deklarimeve në dokumentacionin e dorëzuar.

- ***Paraqitja e dokumentacionit do të kryhet pranë Bashkisë Durrës, në kati i parë, në zyrat e Marëdhënieve me Publikun, me datë 23/03/2023.***

Duke Ju falenderuar,

Lgji. Nr. 1, Sheshi "Liria", tel& fax +355 52 2/223 10, [ëëë.durres.gov.al/](http://ëëë.durres.gov.al/), [e-mail:info@durres.gov.al](mailto:info@durres.gov.al)